



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:033823
Datë: 14.08.2023
Numri i dokumentit: 04582650

C-IV-13-3580

Ankuesi

A S Prizren, ankesa e parashtruar
për babain e tij tashme të ndjerë **F S** nga Prizren.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 14 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Ankesa e ankuesit e paraqitur kundër Vendimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, Nr. PRZ041-0584, të dt.11 nëntor 2013, refuzohet si e pabazuar.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 06 dhjetor 2013, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë për rishikim të vendimit nr. PRZ041-0584, të datës 11 nëntor 2013 të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), më të cilën ka kërkuar kompensim për 50 paga të papaguara, në shumë prej 7,700.00 €, nga N.SH “Liria”-Prizren (në likuidim). Ankuesi pohoi se babai i tij tashmë i ndjerë Faik Sinanaj ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në N.SH dhe për këtë i takon kompensimi i të ardhurave për 50 paga të papaguara në shumë prej 7,700.00 €. Ankuesi i propozon gjykatës që ta aprovoj ankesën e tij si të bazuar dhe ti njihet

kompensimi në shumën e lartcekur me kamatë ligjore, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore. Ankuesi ankesës i ka bashkangjitur kopjen e vendimit të kundërshtuar.

Me 03 shtator 2018, e paditura AKP-ja parashtrori mbrojtje në ankesë dhe e kundërshtoj ankesën ankuesit dhe theksoj se ajo i përmbahet qëndrimit se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe të dispozitave ligjore. AKP tutje pohon se e mbështet në tërësi vendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke iu referuar Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034, nenit 36.2.1, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Nenit 608 të Ligjit për Punë të Bashkuar, për rrjedhën e afatit të parashkrimit. Më tej e paditura pohoi se kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë ose ndonjë autoritet tjetër kompetent brenda 3 viteve nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. E paditura i ka propozuar Gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e AL-së.

Me 15 mars 2023, gjykata lëshoi një urdhër për ankuesit përmes se cilit urdhër ju kërkua që të parashtrorj në dëshmi se është shqyrtuar pasuria trashëgimore, apo se është duke u zhvilluar procedura për shqyrtimin e trashëgimisë së paditësit, për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të trashëgimtarëve të paditësit të ndjerit F S.

Me 24 prill 2023, ankuesi Agron Sinanaj përmes parashtrësës deklaroi se ai është i vetmi trashëgimtarë ligjor i shpallur për babin e tij tashme të ndjerë F S, si dhe i vetmi paditës më këtë çështje kontestimore. Kësaj parashtrëse si provë i njëjti i ka bashkangjitur Aktvendimin e Trashëgimisë me nr. LRP-Nr.ren.6948/13, T.Nr.ref.386/13, i datës 24.12.2013, i vërtetuar tek noter O G me seli në Prizren.

Me 08 qershor 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, përmes së cilit urdhër ju kërkua që të parashtrorje Njoftimin e Ndërprerjes së Marrëdhënies së Punës, pastaj të specifikojë periudhën kohore se për cilën periudhë i kërkon 50 paga, si dhe të prezantojë prova që dëshmojnë që N.SH-ja i ka mbetur borxh babait të tij tashmë të ndjerit Faik Sinanaj pagat të cilat i kërkon për të.

Me 23 qershor 2023, ankuesi përmes parashtrësës u përgjigj ne urdhrin e gjykatës dhe përmes parashtrësës ka bashkangjitur Njoftimin Mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, i datës 30 nëntor 2010 dhe Vërtetimin e lëshuar nga NSH-ja me nr.537, dt.09.12.2010, ku sipas këtij vërtetimi thuhet se punëtori Faik Sinanaj ka stazh pune në N.SH 44 vjet e 08 muaj e 14 ditë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e ankuesit kundër vendimit të AL Nr. PRZ041-0584, refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet relevante të lëndës janë të pakontestueshme dhe lëshon këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Gjykata ka shqyrtuar në tërësi të gjithë materialin e paraqitur në gjykatë nga të dyja palët dhe konstaton si në vijim.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka krijuar marrëdhënie pune me N.SH "Liria"-Prizren, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë me të cilën do vërtetohej se N.SH-ja i ka mbetur borxh atij shumen e pretenduar. Për më tepër ankuesi nuk ka dorëzuar ndonjë specifikacion se për cilët muaj i kërkon 50 paga. Ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara.

Ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të kërkesës së tij edhe pas urdhrorit të lëshuar nga gjykata të datës 08 qershor 2023, për prova që dëshmojnë që N.SH-ja i ka mbetur borxh babait të tij tashmë të ndjerit F S pagat të cilat i kërkon për të, si dhe për të specifikuar periudhën kohore se për cilën periudhë i kërkon 50 pagat e paguara.

Njoftimi për Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës, si dhe vërtetimi për stazh të punës i lëshuar nga N.SH-ja, janë prova me të cilat dëshmohet se Faik Sinanaj ka qenë punëtor i N.SH-së, por nuk janë prova me anë të cilave do provohej se N.Sh-ja i ka mbetur borxh ankuesit shumen e pretenduar. Prandaj edhe për këtë arsye gjykata ka kërkuara nga ankuesi që të dorëzojë prova me të cilat do dëshmohej borxhi i pretenduar, por ankuesi ka dështuara ta provojë këtë.

Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar